

Skënder Rizaj

## NËNTË DOKUMENTE ANGLEZE MBI LIDHJEN SHQIPTARE TË PRIZRENIT (1878-1880)

Në historiografinë e deritanishme, zakonisht, nuk bëhet dallimi në mes të veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të Fraksionit Prosulltan të Lidhjes Shqiptare. Kjo ngatrrësë është bërë edhe në këto nëntë dokumente angleze që po i botojmë në këtë vend.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u formua në gjysmën e dytë të vitit 1877,<sup>1</sup> në krye të së cilës ishte haxhi Ymer efendiu nga Prizreni.<sup>2</sup> Lidhja Shqiptare e kishte komitetin e vet qëndror.<sup>3</sup> Ky Komitet quhej me emra të ndryshëm. P.sh. si: Komiteti Shqiptar i Lidhjes,<sup>4</sup> Komiteti në Prizren i Lidhjes Shqiptare,<sup>5</sup> Lidhja e Sigurisë Kombëtare,<sup>6</sup> Këshilli Qendror,<sup>7</sup> Komiteti i Lidhjes Kombëtare të Shqipërisë,<sup>8</sup> Lidhja Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare.<sup>9</sup>

Kjo Lidhje, e cila u quajt Lidhje e Vjetër, ishte *organizatë nacionale*,<sup>10</sup> e që u quajt edhe Parti e Lidhjes, Parti Radikale,<sup>11</sup> Parti Përparimtare.<sup>12</sup> Partia e Lidhjes ishte Parti e shumicës, Parti e turmave popullore.<sup>13</sup>

Lidhja Shqiptare ishte organizatë politike, ushtarake, revolucionare dhe e pavarur — me fjalë të tjera, ajo ishte Lëvizje Shqiptare ose Revolucion Kombëtar Shqiptar, e cila synonte të formonte një shtet shqiptar autonom. Pra, Lidhja Shqiptare e Prizrenit kishte karakter

<sup>1</sup> The British Museum, London, *Accounts and Papers* (38). 1878-9. LXXIX. 79, pp. 461-477; Public Record Office, London, *F.O. 424/76*, pp. 80-82.

<sup>2</sup> Public Record Office, London, *F.O. 195/1317*.

<sup>3</sup> *F.O. 195/1186*.

<sup>4</sup> *F.O. 195/1236*.

<sup>5</sup> *F.O. 195/1317*.

<sup>6</sup> *F.O. 195/1186; Accounts and Papers* (38). 1878-9. LXXIX. 79, 223.

<sup>7</sup> *F.O. 424/74*, 249.

<sup>8</sup> *F.O. 195/1186; Accounts and Papers* (38). 1878-9. LXXIX. 79, 339.

<sup>9</sup> Constantine A. Chekrez i, A.B. (Harv.), *Albania Past and Present*, New York, The Maxmillan Company, 1919, pp. 51.

<sup>10</sup> *F.O. 424/80*, pp. 333.

<sup>11</sup> Instituti i Historisë, Tiranë, *A. IV. 31*.

<sup>12</sup> *Pa aty*.

<sup>13</sup> Arhiv SSIP-a, Beograd, *Pol. odeljenje. Pov. br. 269, 1879. F. III. Dosje V.*

nacionalçlirimtar, panshqiptar, anttiimperialist, social dhe multikonfesional.<sup>14</sup>

Fraksioni Prosulltan, ndërkaq, u formua në Kuvendin e Kuvendit të Lidhjes Shqiptare, i cili u mbajt me 10 qershor 1878, në Prizren, Akti i themelimit të këtij fraksioni ishte Kararnameja.<sup>15</sup> Kryetar i këtij fraksioni të Lidhjes ishte Abdullah pasha, i cili u vra bashkë me Mehmet Ali pashën, në Gjakovë nga Lidhja e Prizrenit, pastaj, për kryetar u zgjodh Ahmet Ruhi (Mustafa — S.R.) efendiu, një sheh nga Tetova.<sup>16</sup>

Sheh Mustafa qe i detyruar ta transformojë Partinë e vet, duke e bërë rizgjedhjen e deputetëve për Asamblenë që do të tubohej në Prizren dhe e cila do të përfaqësonte popullsinë myslimane të tërë Shqipërisë. Lidhur me këtë ai dërgoi ftesat në çdo krahinë dhe qytet, por asaj iu përgjegj vetëm kleri, i cili i kishte ndërmarrë masat drejtë transformimit të Lidhjes së Vjetër nga organizata nacionale në një organizatë fetare. Kjo organizatë fetare kishte për qëllim t'i kundërshtonte të krishterët, brenda dhe jasht kufijve të vendit.<sup>17</sup>

Kështu Fraksioni Prosulltan u quajt Parti moderne ose Parti e Qeverisë,<sup>18</sup> që pareshtur luftoi kundër Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

### 1. Zëvendës konsulli Summa markizit të Salisburyt

(Telegrafik)

Shkodër, 14 qershor 1878.

Vojvoda malazez, Verlica, i cili është kthyer në Cetinë më 11 të këtij muaji, i tha valiut (të Shkodrës — S.R.) se çështja e lëshimit të pozitave të okupuara nga ushtria malazeze pas armëpushimit mund të vendoset vetëm nga Kongresi (i Berlinit — S.R.). Më 10 qershor Vezirit të Madh iu dërgua një protest, protest ky i nënshkruar nga banorët e Podgoricës, të Shkodrës, nga të gjithë malësorët, si dhe nga vet Mirditasit. Të nënshkuarit deklaruan se do të rezistojnë me armë çdo tentim të marrjes së tokës së tyre, dhe me telegram kërkuan që banorët e të gjitha krahinave të Shqipërisë, t'i bashkohen Lidhjes. Në rast se ndonjë territor do t'i jepet Malit të Zi, përtej pozitave që ata i zënë tani, do të merren masat e sigurimit. Lidhur me këtë iu dërgua urdhëri i rrept valiut të Shkodrës për të penguar gjakderdhjen.

(Public Record Office, London, *F.O. 424/71*, pp. 174).

<sup>14</sup> Skënder Rizaj, *Synimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, Gjurmime Albanologjike, Seria e shkencave historike, VIII-1978, Prishtinë, 1979, 183, 184.

<sup>15</sup> Sadullah Brestovci, *Kararnameja — program i parë i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, Gjurmime Albanologjike — Seria e shkencave historike, VIII-1978, Prishtinë, 1979, 185-205; Skënder Rizaj, *vep. e cit.*

<sup>16</sup> *F.O. 424/79*, pp. 164-169.

<sup>17</sup> *F.O. 424/80*, pp. 333.

<sup>18</sup> Instituti i Historisë, Tiranë, *A. IV. 31*.

2. *Ndihmës konsulli Summa markizit të Salisburyt*

(Telegrafik)

Shkodër, 9 korrik 1878.

Delegatët e Ejaletit të Shkodrës dhe malësorët fqinjë, të cilët tani vonë kishin shkuar në Prizren, u kthyen në Shkodër. Komiteti (i Lidhjes Shqiptare — S.R.) kishte vendosur t'i dërgojë një ultimatum Serbisë dhe Malit të Zi, duke kërkuar prej tyre kthimin e të gjitha territoreve shqiptare që Kongresi iu kishte dhënë, dhe po që se refuzojnë, të gjithë shqiptarët do t'i rrokin armët për ta realizuar kërkesën e tyre. Provinca e Shkodrës dhe krahinat e Dibrës, të Matit dhe të Ohrit do të japin 60.000 burra për ta sulmuar Malin e Zi.

Në Shkodër ka shumë rezerva armësh, municioni, dhe të ushqimit. Komiteti i përbërë prej delegatëve, i udhëheq të gjitha veprimet e kryesuesve, i mbledh dhe i inkurajon anëtarësimet.

Valiu mbetet pasiv duke mos i kundërshtuar vendimet e mara nga Komiteti.

Dërguar Ambasadës Britanike në Stamboll.

(Public Record Office, London, *F.O. 424/72*, pp. 56).

3. *Sër H. Elliot markizit të Salisburyt*

Im Lord,

Vjenë, 10 shtator 1878.

Lajmi i vrasjes së Mehmet Ali pashës la vraga të thella e aspak të mira për Turqinë, dhe jo të padukshme që tregohen dëmtuese të mëdha të interesave të saja, po që se Porta menjëherë nuk ndërmerre masa të rrepta për ta vërtetuar autoritetin e saj në Shqipëri.

Nasri pasha, qeveritar i Sanxhakut të Jeni Pazarit, është i dyshimit, në bazë të pandehjeve të patundshme që ta rezistojë hyrjen e austriakëve, ai e favorizoi organizatën me armë e material luftarak me një sasi të madhe të cilat silleshin nga Mitrovica. E tërë kjo nuk mund të ketë ndodhur së paku pa përzierjen e gishtrinjeve të tij.

Shumë njerëz e akuzojnë Portën për rolin e dyfishtë që luan, dhe për dëshirën që të vështësojë përparimin austriak; prandaj, ata me maturi të madhe janë të kënaqur me qeverisjen e Lidhjes Shqiptare deri sa Qeveria e Sulltanit tregohet e dobët dhe pashpresë.

Cilado qoftë pikëpamje të ketë qenë marrë në këtë çështje, nëse Lidhja është zotuar që të zhvillohet vetvetiu, ashtu që të organizojë rezistencë të fortë në territorin e rrethuar me shtete të huaja, efekti mund të jetë i njëjtë.

Austria ka qenë e ftuar nga Evropa që të marrë administrimin e Bosnjës dhe të Hercegovinës, sepse Porta, në këto provinca nuk kishte autoritet të mjaftueshëm për t'iu siguruar qetësinë; dhe nëse Lidhja merrë përsipër masa të mëdha në territorin e rrethuar me shtetet e huaja, derisa Porta tregohet e dobët për ta frenuar atë, një kërkesë e ngjashme do t'i paraqitet Austrisë për ta marrë administrimin edhe të kësaj krahine. Prandaj është në interes të Portës për të treguar se ka autoritet të mjaftueshëm, sepse të tjerët, mund të jenë të gatshëm për t'i marrë nëse ajo vetë tregohet e pafuqishme.

Qeveria Serbe ndien, ose botërisht tregon se ndien, shqetësim të madh për sulmin që i kërcnohet nga shqiptarët, i cili sulm, nëse ndodhë, do të ketë përfundim — gjenë më të frikësueshme — fillimin e luftës së Principatës Serbe me Austrinë kundër armikut të përbashkët.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) Henry Elliot.

(Public Record Office, London, *F.O. 424/74*, pp. 164, 165.)

#### 4. *Konsulli Kirby Green* markizit të *Salisbury*t

Im Lord,

Shkodër, 2 nëntor 1878.

Në shkresën time politike No. 83, të datës 22 të muajit të kaluar, pata nderin Zotërisë Tuaj t'i parashtrojë një raport të udhëheqësit të mashtruar nga një farë sheh Mustafa i Tetovës, për çështjen shqiptare, rreth së cilës u zhvilluan deri diku ngatërresa të shkaktuara nga zilia dhe mosmarrëveshjet e brendshme të Lidhjes.

Veprimi i shehut, i lajmëruar me telegramin e pardjeshëm, i ringjalli shpresat e humbura të shqiptarëve myslimanë, në mënyrë që së shpejti të mbahet kuvendi i Lidhjes duke pasur parasysh pothuajse urdhërin e drejtpërdrejt të Sulltanit; shehu u kujdes të krijojë përshtypje se ishte kthyer nga Stambolli i dhuruar me fuqi të jashtzakonshme.

Banorët e Shkodrës janë aq të sigurtë se Qeveria Turke e inspiroi përtrirjen e organizatës së tyre të vonshme, sa që ata e shtyen zgjedhjen e delegatit të tyre derisa të mund të vërtetojë nga valiu, i cili gjendet në Kavajë, për kandidatin që dëshiron të zgjedhet.

Kolegu im austriak, M. Lippich, përtrirjen e aktivitetit të Lidhjes e lidh me koncentrimin e ushtrisë (austriake — S.R.) në Vilajetin e Kosovës, dhe, nëse, siç dëshmon ai, nuk hiqet dorë nga okupimi i Sanxhakut të Jeni Pazarit (nga Austro-Hungaria — S.R.), por vetëm shtyhet deri në prandëverë, përgatitjet për rezistencë mund të jenë baza që ai (M. Lippich — S.R.) iu atribuan atyre.

Nga një burim personal kuptova se seraskeri (kryekomandanti — S.R.) brenda ditëve të fundit e thirri këtu komandën e përgjithshme, për vlerësimin e menjëhershëm të sasisë së municionit, të cilën, forcat e tij ushtarake, do ta kërkojnë për dymbdhjetë muaj të shërbimit aktiv.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) W. Kirby Green.

(Public Record Office, London, *F.O. 195/1186*; *F.O. 424/76*, pp. 191).

5. *Togeri Roos i Blandensburgut majorit Wilson, R.E.*

Sër, Selanik, 30 dhjetor 1878.

Kam nderin t'iu përcjell informatat që pasojnë lidhur me Lidhjen Shqiptare dhe gjendjen e përgjithshme të vendit në Vilajetin e Prishtinës (Vilajetin e Kosovës — S.R.)

Shkaqet që ndikuan në formimin e Lidhjes mund të jenë:

1. Fakti që gjatë luftës, Turqia Veriore gati u zhvesh tërësisht nga ushtria. Çdo njeri i aftë kërkohej të ishte në dispozicion për luftë kundër Rusisë. Vendi, kështu, ishte i pambrojtur. Prandaj populli ishte i detyruar të mbrohej vetë.

2. Frika e sllavëve.

Pothuajse të gjithë banorët e pjesës perëndimore të Sanxhikut të Nishit, tani vonë të dorëzuar Serbisë, ishin shqiptarë, dhe të besimit mysliman. Ata zinin shumicën e fshatrave në perëndim të vijës së tërhequr në të majtë të Moravës, afër Nishit, Leskovcit dhe të Vranjës, duke e përfshirë Prokuplen (Urkub) dhe Kurshumlinë. Dhe, në të vërtetë, proporcionalisht një pjesë e madhe e banorëve të qyteteve të Leskovcit dhe të Vranjës ishin poashtu shqiptarë. Nën sundimin turk dy racat (shqiptarët dhe serbët) ishin të aftë të jetojnë së bashku në mënyrë tolerante, dhe besoj se deri, për afërsisht, para katër vjetësh, kur trazirat e tanishme mund të supozohet se kishin filluar, çdo gjë ishte në rregull në këtë pjesë të Perandorisë Osmane. Mirëpo, në të vërtetë, kurrë më nuk do të mund të bashkohen. E, shkakun qëndron në fanatizmin fetar të të dy palëve. Kjo urrejtje nuk ekziston në mes të myslimanëve dhe të shqiptarëve të besimit katolik. Këta të fundit, d.m.th. shqiptarët e besimit katolik, e kanë të njëjtën frikë nga sllavët si edhe bashkatdhetarët e tyre të besimit mysliman. Është e dijtur mirë se sllavët nuk tolerojnë fe tjetër, pos të vetës. E, kështu, kjo ishte ngulitur në kokat e fshatarëve shqiptarë sa që ishin të mendimit se do të ishte e pamundur për të jetuar nën serbë me çfarëdo shkalle të lirisë. Prandaj, kur Sanxhaku i Nishit u shkel, e ata nuk ishin mësuar t'i bashkonin veprimet luftarake, e në anën tjetër intelegjenca jo e mprehtë e udhëheqësve, nuk iu bëri ballë pushtuesve. Ata të gjithë ikën në Vilajetin e

Prishtinës, duke e lënë tërë vendin të zhveshur nga popullata e vet. Llogaritet se tani ka 60.000 deri 70.000 refugjatë shqiptarë të shpërndarë nëpër vilajet. Ata, kurrë nuk do të kthehen në fshatrat e mëparme, sepse shumica prej tyre kanë humbur gati çdo gjë. Janë në pikëllim dhe në mjerim të madh.

### 3. Zmadhimi territorial i Malit të Zi.

Kjo është, nga të gjitha, arsyeja më kryesore që shpini në themelimin e Lidhjes; dhe është ajo që i shqetësoi shqiptarët shumë. Në të vërtetë është shkaku kryesor pse Lidhja vazhdon të ekzistojë.

Kufiri i ri malazez përfshinë një rën nga pjesët më kryesore të Shqipërisë, gjegjësisht, Gucinë e Plavën. Qendra e jetës natyrale të shqiptarëve është në Plavë. Ajo është mu zemra e vendit. Dhe është e banuar me parësinë shqiptare më me influencë dhe më të pasur. Fushat e Gucisë janë, gjithashtu, vende ku shqiptarët i zbresin kopetë e deleve për të dimëruar. E kuptoj se delet i zbresin poshtë gjatë motit të lig kur nuk mund të gjendet në kodrina asgjë. E, meqë ata më tepër merren me blegtori se sa me kultivimin e tokës, mjetet për ekzistencë të disa fiseve u vunë në rrezik, për shkak të të falurit e këtyre krahinave Malit të Zi. Dihet, gjithashtu, se shqiptarët afër kufirit malazez, pothuajse plotësisht, janë të pavarur nga Porta. Ato janë fise të pamposhtuara, të cilët nuk kuptojnë sesi tokat dhe të mirat e tyre mund t'iu rrëmbejnë pa miratimin e tyre. Kurrë vendi i tyre nuk është pushtuar me forcën e armëve. Pastaj Marrëveshja e Shën-Stefanit dhe e Berlinit i shtyri të mbrohen vetë, atëherë kur turqve nuk iu shkoi përdore ashtu të veprojnë. Kështu, shqiptarët formuan Komitetin e Sigurimit Publik, të cilën Qeveria Osmane nuk është aq e aftë për ta rezistuar.

Nuk mendoj se okupimi i Bosnjës ka lidhje me Lidhjen Shqiptare. Interesi i dy trevave ndryshon. Racat janë të ndryshme. Dhe, kjo e fundit, Lidhja, po i shikon punët e veta. Është e vërtetë se Bosnjës iu dërgua ndihma nga Prizreni. Por okupimi nuk iu bëri atyre, shqiptarëve, ndonjë përshtypje. E, as që do të ishte i përshtatshëm, tani për tani, bashkimi i tyre (shqiptarëve dhe i boshnjakëve të Bosnjës). Sidoqoftë, nëse Austria, tani, i largohet pozitiva të cilat i ka zënë për të hyrë në Sanxhakun e Jeni Pazarit, Shqipëria do të kërcnohet e Lidhja do të veprojë.

Është e pasigurtë të thuhet se sa Porta është përgjegjëse për Lëvizjen e tanishme. Shumica thonë se në fillim, Porta, e kishte përkrahur për të bërë një demonstrim në Evropë, e për të treguar se çështja shqiptare ekziston, sikurse ajo serbe e malazeze, për të cilat kujdesen shumë Fuqi Perëndimore. Sidoqoftë, për mua ishte e pamundur që ta kuptoj gjendjen e vërtetë të çështjes në fjalë.

Lidhja ekziston qysh prej muajit maj ose qershor. Qëllimi kryesor i saj është ruajtja e krahinës së Gucisë (në të cilën krahinë, besoj se s'ka asnjë sllav) dhe të atyre pjesëve të Shqipërisë të falura Malit të Zi. Pastaj rezistimi i ndonjë pushtimi tjetër sllav, nëse ai ndërmerret, dhe kundërvënja e austriakëve, nëse ata u afrohen. Para afro dy muajve, kur

isha në Prepolc, besoj se mora vesh se do të ishte vështirë të caktohet kufiri serb atje dhe në Malet e Gollakut. Por prej atëherë gjërat u qetësuan. Nuk ma merr mendja se do të ketë ndonjë trazi në atë qark. Por më thotë mendja se tani do të ishte gati e pamundur të caktohet kufiri i ri malazez në Shqipëri. Sepse, siç thash më parë, mbrojtja e asaj ledine është kujdesi kryesor i popullit. Ata frikësohen se me humbjen e saj do të binë nën robërinë e Princ Nikollës.

Lidhja, sikurse është menduar, nuk është sajuar nga bajraktarët e fiseve. Lëvizja është më tepër religjioze se sa laike, e udhëhequr nga myftinjtë, ylematë, kadilerët dhe nga anëtarët e Këshillit të qytetit. Komiteti Kryesor është përqëndruar në Prizren. Por, çdo qytet e ka edhe nën-komitetin. Kryetar i Lidhjes ishte Abdullah pasha, i cili u vra bashkarisht me Mehmet Ali pashën, e tani është Ahmet Ruhi Efendiu, (*Mustafa — S.R.*), një sheh nga Tetova. Në Prizren udhëheqës janë haxhi Ymer efendiu dhe Halim efendiu. Kurse në Prishtinë janë myftiu i Prishtinës dhe Zia beu, një shqiptar i pasur, pronar tokash në Prishtinë dhe përrreth saj. Ahmet Hamdi efendiu, i njohur me mbiemrin „Korenica”, mu ai i cili e udhëhoqi sulmin kundër Mehmet Ali pashës, është udhëheqës në Gjakovë. Në Pejë e Gjakovë janë të tjerët, emrat e të cilëve nuk i di. Por këta të cilët i përmenda janë personat më me influencë. Do të shtoj, poashtu, se myftiu i Tashlixhës (Plevla), i cili ishte në krye të opozitës kundër austriakëve në Doboj, dhe i cili korri sukses kundër gjeneralit Zaporit (Szapory), tani gjendet në Pejë. Ma merr mendja se gati çdo fis, ose klan, i Shqipërisë Veriore (Gegëri), Lidhjes i dërgoi përfaqësuesit e vetë. Janë njoftuar, se Mirditasit, disi po rrijnë indeferent ndaj Lëvizjes. Toskët, ose shqiptarët e jugut, mësa dëgjova, nuk kanë të bëjnë me Lëvizjen. Qytetet dhe komitetet e ndryshme nuk janë të bashkuara siç mund të ishin. Ekzistojnë disa parti, xhelozitë dhe interesat private (personale) në mes të anëtarëve të Lidhjes, të cilët e dobësojnë efikasitetin e saj. Elementi më i spikatur i disharmonisë dhe antagonizmi më i madh ndaj Qeverisë (Portës), siç duket vjen, nga Prishtina. Thuhet se, Zia beu shpreson të bëhet princ i ardhshëm i Shqipërisë, e kolegu i tij, myftiu i Prishtinës, i takon partisë së tij terësisht.

Mu kah mbarimi i gushtit ose fillimi i shtatorit turqit ushtrinë e Kosovës e transferuan për në Shqipëri. Por prania e tyre nuk e ndërpreu punën e Lidhjes, për arsye se ajo u bë më e fuqishme se ajo (ushtria), e cila u përkrah nga Porta. Vrasja e Mehmet Ali pashës nuk prishi punën. Lidhja, tani, është në të njëjtën fuqi, siç ishte edhe më parë.

Siç Ju informova në Raportin No. 3 turqit nuk kanë ushtri në këto pjesë të Shqipërisë, të zaptuara nga Lidhja. Rendi ekziston. Administrohet sipas zakonit të tyre, krejtësisht nga anëtarët e komiteteve. Në të vërtetë, në shumë qytete, ku ekziston sundimi juridik turk, Lidhja e ka pushtetin superior, gjithësesi në punët e brendshme. Eksporti i drithit nga Shqipëria ka qenë ndaluar nga Lidhja. Në Prishtinë, po ashtu, para një kohe të shkurtër, një shqiptar shtiu kundër një njeriu, sipas zakonit të vendit, për

t'ia marrë hakun për fyerjen që ia paska bërë. Ai u soll para Komitetit të qytetit dhe u dënua me shkatërrimin e shtëpisë së tij, dënim ky i cili u ekzekutua. Valiu që i paaftë të veprojë edhe pse Prishtina është selia e administratës së tij. Në shumë raste banorëve iu ndalohet bartja e armëve. Ky rast është në Prishtinë, ku ata janë të detyruar t'i mbajnë armët në shtëpi. Lidhja, në të vërtetë, shumë mirë e ruan rendin. Jam njoftuar se vendi në këtë moment është mjaft i qetë dhe paqësor. Besoj plotësisht se çdo i huaj është i sigurtë, nëse dihet se nuk është armik i shqiptarëve, i cili dëshiron të udhëtojë në këtë vilajet. Duhet të kihet në mend se kusaria është e panjohur. S'ka plaçkitje. E krimet plotësisht janë të kufizuara brenda hakmarrjeve private ose vrasjeve për arsytet politike.

Të gjitha këto tregojnë se pushteti i Portës nuk është shumë i fuqishëm në Shqipëri. Bile edhe ku ekziston ushtria turke autoritetet legjitime kanë pak pushtet, ose s'kanë aspak. E aq më tepër tregon rasti, kur Valiu dëshiron të ngreh kërkesat me shkrim për furnizimin e ushtrisë, është i detyruar që kërkesën t'ia parashtojë Lidhjes për aprovim. Lidhja, pra, e jo Qeveria legjitime (Porta), është ajo që i vjelë taksat (tatimet) ligjore në çdo krahinë.

Shqiptarët, duket, janë mjaft mirë të armatosur, e për municion thuhet se kanë shumë. Kah Prishtina pashë shumë pak pushkë „Martini-Peabodies”, pushkët zakonisht ishin me saçme, e disa ishin „Snidersa”. Megjithatë, në vend ka, bukur shumë, pushkë të markës „Martini”, për shkak se, Mehmet Ali pasha, kur ishte atje gjeneral, iu shpërndau fshatarëve shumë armë, e që atëherë ata kanë edhe më shumë. Lidhja, gjithashtu, i mbanë listat e përgatitura për ata të cilët shërbejnë si „bashi-bozukë”, (ushtri jo e rregulltë), e shumica prej tyre po bëhen, vazhdimisht, pjesëmarrës. Natyrisht, elementi më kryesor në krijimin ose dëmtimin e efikasitetit të Lidhjes qëndron në aftësinë e udhëheqësve të saj. Nuk e di se a kanë ndonjë udhëheqës të mirë, njerëz me karakter e fuqi të mjaftueshme për ta udhëhequr Lëvizjen, Lidhjen, me mendjehollësi, dhe për t'i mbajtur fiset të bashkuar e në disiplinë, kur paraqitet rasti. Myftiu i Plevlës u tregua bukur shumë i aftë, por mbetet të shihet se të tjerët për ç'punë janë të përshtatshëm. Ose do të bashkohen ose xhelozia dhe grindjet do t'i përçajjnë plotësisht.

Kur isha në Prishtinë, anëtarët e Lidhjes ndodheshin atje, me qëllim për t'u këshilluar me Valiun, Nazif pashën. Erdhën nga të gjitha anët dhe u mblodhën në Prizren, para se të shkonin te Pasha. Në mes tyre ishte Korenica, i përmendur më parë, i cili ishte shkaktar i vdekjes së Mehmet Ali pashës. Mu dha rasti ta takojë në shtëpinë e Valiut. Vura re se u pranua mirë e më vonë e pashë, përsëri, me gjeneralin, Nuri pashën. Fakti është se asnjë nga vrasësit të Mehmet Ali pashës nuk u dënua. Me fjalë të tjera këtu është një nga vrasësit (bashibozukët) kryesor, i cili, në të vërtetë, u pranua nga autoritetet turke të Vilajetit. Nuk munda ta zbuloj arsyen e vërtetë të vizitës së udhëheqësve të Lidhjes që ia bënë valiut. Thuhet se, vizita ishte gjoja sekrete, të cilën nuk e dinte as vetë gjenerali. Sidoqoftë, me thanë se

kishte gjasa, se në Prishtinë erdhën për arsye të fjalës së përhapur mu para bajramit (më 5 dhjetor) se serbët po e koncentrojnë ushtrinë në Kurshumli, të cilën gjë e përmenda në Raportin No. 2, e për këtë erdhën te Valiu, për arsye të ndihmës reciproke. Është e mundshme, po ashtu, se prezenca e tyre ka të bëjë me lëvizjen austriake, në rast se synojnë të depërtojnë kah Jeni Pazari. Myftiu i Plevlës, afro para dy javësh, para se të vinte në Prishtinë, nga Peja u përcoll prej nja 600 ithtarëve të vet. Poashtu ndjeva se Ahmet Rushi efendiu (Mustafa S.R.), sheh i Tetovës, dhe udhëheqës i Lidhjes, dy herë kishte vajtur në Stamboll, për ta vizituar Sulltanin.

Nga kjo që raportova, mendoj se është e qartë se Porta dhe Lidhja tani janë në marrëdhënie të mira dhe janë duke bashkëpunuar për t'i dalur në krye qëllimit të përbashkët — mbrojtjes së vilajetit. Nuk ka dyshim se Turqia posedon material të shkëlqyeshëm për ushtri në Shqipëri — ushtri kjo që do të formojë një milici të fuqishme ose një ushtri territoriale, kundër ekspansionit të sllavëve. Këtu janë, njerëzit, njerëzit e aftë për të luftuar trimërisht. Por kjo begati kërkon zhvillim dhe administrim të mirë. A do të jetë e aftë lidhja të organizojë një mbrojtje të mirë, në rast nevoje, është vështirë të thuhet. Nëse Qeveria Osmane e merr vetë çështjen në duar, padyshim, do të jetë e aftë për t'i dhënë fuqi të madhe Lëvizjes Shqiptare e të krijojë një lloj ushtrie kufitare në atë pjesë të vet të Perandorisë, u mor vesh, deri diku, siç ishte ajo, e organizuar nga Austria, kur turqit ishin kamxhik i Evropës. Një politikë e tillë do të ishte shumë rëndësishme për t'i kontrolluar shkatërrimet e vazhdueshme të sllavëve që bënin në vend, e Portës do t'i mundësohej që t'i angazhonte fuqitë e veta ushtarake dikah tjetër kur të kërcnohej rreziku. Sidoqoftë, duhet të kihet në mend, se ekziston një arsye tjetër e madhe e cila i detyron turqit që ta lënë Lidhjen rahat. Është çështja e Gucisë. Sipas Marrëveshjes së Berlinit ata (turqit) janë të detyruar të heqin dorë prej asaj krahine. Poqese, atëherë, pushteti i tyre (i turqve) zgjerohet mbi Shqipërinë, ata (turqit) do të detyrohen ta mposhtin kryengritjen vigane të popullit të vet (të shqiptarëve — S.R.), vetëm e vetëm për ta zbatuar vendimin e Marrëveshjes. Ata (turqit) do ta shndërrojnë dashamirësinë e tërë popullit (shqiptar) në armiqësi, dhe me siguri në vend të tyre (të turqve) do të futen (shqiptarët) nën influencën e ndonjë fuqie kundërshtare.

Vice-konsulli rus në Selanik, oficer ushtarak, i quajtur Olianov (Oulianoff), — mu ai i cili e vizitoi Rumelinë para se të shpërthente masakrimi bullgar — erdh në Prishtinë, kur isha edhe unë atje. Më thanë se dëshironte për ta vizituar tinëz vendin, por kishte kuptuar se ashtu nuk mund të vepronte. Agjentët tjerë rusë gjetën mënyrën për të shkuar në Shqipëri. E njëri prej tyre, jo moti, ishte diktuar në Mitrovicë. Atë e kishin kthyer kah kishte ardhur. Nuk mund të them, se, ata (agjentët rusë) u kishin shpërndarë të holla disave ndër më të këqinjve të Lidhjes. Por është e mundshme, sepse, ata janë punësuar me aktivitete për të bërë intriga në vend. Posaçërisht, siç kuptova, M. Hitrovi, tani vonë konsull i përgjithshëm

në Stamboll, ishte emëruar në Selanik, e me të njëjtën detyrë edhe në Maqedoni. Myftiu i Prishtinës, anëtar kryesor i Lidhjes, konsiderohet si një rryshfetmarrës.

Para se ta mbyll këtë raport, do të kisha thënë disa fjalë mbi vrasjen e Mehmet Ali pashës. Ka shumë rrëfime lidhur me arsyen kryesore të vrasjes, por ajo më e mundshmeja, siç dëgjova, është kjo që vijon: — Mehmet Ali pasha ishte mirë i njohur në Shqipëri, por aspak i dashur. Me të drejtë ose pa të drejtë besohet se, bile edhe para luftës së fundit, i kishte përkrahur malazezët, dhe kishte urdhëruar që t’iu jepen disa vende me rëndësi. Këtë e kuptova prej një gjenerali turk, i cili qe shumë intim me mua, dhe i cili kishte shërbyer me te në atë krahinë. Ai tha se gjuha e tij kishte qenë e pakontrolluar pa masë, dhe si rrjedhim i kësaj kishte fituar famë të keqe. Kur kishte shkuar në Shqipëri me qëllim që ta bind Lidhjen për ta dorëzuar Gucinë, ai ishte konsideruar si një armik i fshehtë, instrument i Berlinit, i angazhuar për t’iu bërë dëme të mëdha. Xhelozitë private gjithashtu vepronin në mes të udhëheqësve të Lidhjes. E Abdullah pasha, nikoqir i Mehmet Aliut, kishte armiq dhe rivalë. Gjenerali turk me të mbrijtur në Gjakovë bisedoi me Ahmet efendi Korenicën. Në fund, ky i fundit, e ngriti popullin kundër tij. Dhe e vranë at, në atë mënyrë që tanimë është mirë e njohur.

Kam nderin, etj.

(Nënshkrimi) John Ross i Bladensburgut, toger.

(Public Record Office, London, *F.O. 424/79*, pp. 164-169)

#### 6. *Konsulli Kirby Green markizit të Salisburyt*

Im Lord,

Shkodër, 13 janar 1879.

Kam nderin të raportojë se Kuvendi i Përfaqësuesëve të Lidhjes Shqiptare e ka përtrirë aktivitetin brenda katërmbëdhjetë ditëve të fundit, dhe në këtë kohë, sikurse në të gjitha rastet e tjera, ç’prej lindjes së Lidhjes, autoritet turke kanë gishtë në vendimet e saj.

Nazif pasha, vali i Kosovës, e kryesoi Mbledhjen e Kuvendit të Ri të mbajtur në Prishtinë, kur u vendos të ftohen të gjithë shqiptarët nën armë nga mosha 16 deri 60 vjeçare. Zyrtarët turq, shumica e qeveritarëve thuhet se kishin premtuar se do të pajisin me pushkë „Peabody-Martini”, dhe me municion të mjaftueshëm, çdo njeri të regjistruar.

Me qenë se vendimet e Kuvendit ishin marrë me dyer të mbyllura, shkak i përdorimit të kësaj mase luftarake nuk u dëgjua. Pëshpëritet, prandaj, se Lidhja ka vendosur që të mos kundërshtojë afrimin e austriakëve deri të Jeni Pazari, ashtu që për të qenë e zonja të përdorë tërë fuqinë e vet, nëse paraqitet tentimi i okupimit të kazasë së Mitrovicës.

Përfaqësuesi i dërguar në Kuvend nga Shkodra u kthye këtu, dhe menjëherë shfaqti pakënaqësinë e vet, lidhur me mënyrën se si lutja e tij, për ndihmë, ishte pranuar nga Lidhja. Ai (përfaqësuesi) thotë se Lidhja ishte marrë më shumë me plane të kota, d.m.th. me kundërshtimin e afrimit të austriakëve, se sa me masat të cilat duhej marrë në pengimin e copëtimit të vendit të tyre, copëtim ky që i kanosej.

Sa më shpejt që e kuptonin zyrtarët turq në Shqipëri se ata nuk duhet t'i mbanin frerët, të cilët e nxisnin lëvizjen e Lidhjes, aq më mirë do të ishte për Qeverinë Perandorake, me qenë se themelimi i Lidhjes qëndronte në baza të patundshme dhe se për rrënjën e saj të domosdoshme duhej vetëm varrosja e pa pra e atyre që e themeluan dhe që e përkrahin atë.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) W. Kirby Green.

(Public Record Office, London, *F. O. 424/79*, pp. 377, 378.)

#### 7. *Konsulli Kirby Green markizit të Salisburyt*

Im Lord,

Shkodër, 21 janar 1879.

Kam nderin të raportoje se ditëve të fundit kam pasur raste të shpeshta të bisedojë me zotërinj mysliman të vendit të cilët kanë marrë pjesë aktive në punët e Lidhjes Shqiptare, e, nga Jusuf efendi Golemi, i cili ishte zgjedhur, tani vonë, për të përfaqësuar Shkodrën në Kuvend, të mbajtur në Prizren dhe në Prishtinë, mora plotë hollësi mbi planet dhe shpresat e Lidhjes.

Jusuf efendiu më tha se Kuvendi (i Prishtinës — S. R.) ishte ftuar nga Kryetari i tij, sheh Mustafa, nga Tetova, të cilin, ndonëse e kishte pranuar tani vonë Sulltani në vizitë, në Stamboll, duke i kushtuar përfillje të madhe, prapsepap, Lartëmadhëria e Tij e kishte shtyer që t'i bindë bashkatdhetarët e tij se ishte absolutisht gjë e detyrueshme për t'iu nënshtruar vendimeve të mara nga Kongresi i Berlinit. Sipas deklaratës së Shehut, ai iu kishte përgjigjur Sulltanit se shqiptarët nuk mund të marrin me mend vlerën e ekzistencës pas sakrificimit të territoreve të rekomanduara, të cilat u aprovuan dhe u pranuan si të vetat në Kuvend.

Vendimi, pastaj, u mor që menjëherë të fillojnë përgatitjet për mbrojtjen e Shqipërisë nga copëtimi i saj, dhe se pandehet se ishte bërë regjistrimi i 80.000 luftërave. Çdo njeri kishte pranuar që me armë në dorë do ta vëjnë jetën në rrezik për hir të atdheut të tyre dhe se kur operacionet aktive të fillojnë komandantët e ushtrive të ndryshme do të jenë të autorizuar për t'i furnizuar ushtritë e veta me ushqim të mbledhur nga

katundarët dhe qytetet, furnizim ky që do të paguhet, më vonë, nga Fondi Kombëtar.

Jusuf efendi Golemi ishte urdhëruar që të kthehet për në Shkodër, dhe menjëherë të raportojë për sheh Mustafën. Ai i kishte parë shenjat e rrezikut, dhe se forca prej 20.000-30.000 shqiptarëve, duhej menjëherë të armatosej në Vilajetin e Kosovës dhe në Dibër, dhe të dërgohej për në kufirin malazez në këtë drejtim.

Letra e nënshkruar këtu (në Shkodër — S. R.), nga shumica e udhëheqësve myslimanë, u dërgua pak para ardhjes së Qamil pashës dhe se gjer tani ajo do të duhej të arrijë në Komitetin e Lidhjes në Prizren.

Jusuf efendi është i bindur se masat aktive do të merren pa vonesë, vetëm nëse Podgorica dhe Shpuza nuk janë dorëzuar gjatë ditëve të fundit. Në qoftë se kjo ka ngjarë, Lidhja është plotësisht e bindur se do të ishte e kotë përpjekja për t'i rikthyer ato nga Mali i Zi, e kjo, pastaj, do të mund t'ia tërheqte vëmendjen Malit të Zi që t'i anulojë vendimet e Berlinit me mënyra të tjera.

Ai tha se Turqia pat sukses që ta prish Konferencën e Stambollit; Anglia e grisi Marrëveshjen e Shën-Stefanit, e Shqipëria do të veprojë po ashtu me atë të Berlinit. Shqipëria e kishte rastin e përshtatshëm për të vepruar ashtu, sikurse t'ishte e siguar nga mos ndërhyrja e Fuqive të Mëdha, e xhelozia reciproke e Austrisë dhe e Italisë e shpëtuan atë nga rreziku i okupimit të huaj.

Pa tjetër duhem ta sigurojmë Zotërinë Tuaj se nuk i mata fjalët për ta bindur këtë delegat për pikëpamjet e tij fëmijore dhe për padijen që iu mundësonte atyre ekzistencën; e kur ai mori guximin t'i përmend veprimet të cilat e kishin erën e kërcnimit, unë e binda se Lidhja, edhe nëse i vret dhe i helmon komisionarët perandorak (të Sulltanit — S.R.), madje, edhe nëse, përpiqet t'i fyejë të huajt, do të jetë e pafuqishme për t'i mospërfillur vendimet e Evropës.

(...)

Kam nderin, etj.

(Nënshkrimi) W. Kirby Green.

(Public Recor Office, London, *F. O. 424/80*, pp. 35, 36.)

#### 8. Konsulli Kirby Green markizit të Salisburyt

Im Lord,

Shkodër, 5 shkurt 1879.

(...)

Brenda disa javëve të fundit, në anën tjetër, u bë një ndryshim. Udhëheqësit e Lidhjes dhe delegatët e Kuvendit Kombëtar (the National

Assembly), të cilët ishin ose nëpunës të Qeverisë, kandidatë për detyrë zyrtare, ose sipërmarrës ushtarakë, i ndërprejnë lidhjet e tyre me Lëvizjen. E sheh Mustafa, nga Tetova, u detyrua të transformojë Partinë e vet.

Ai i dërgoi ftesat çdo qyteti dhe krahine për rizgjedhjen e deputetëve për Asamblenë e cila do të tubohej në Prizren, asamble kjo e cila do të përfaqësonte popullsinë myslimane të tërë Shqipërisë, dhe jo sikurse deri më tani, vetëm sanxhaqet veriore të saj. Ndërkaq, ftesës iu përgjegj vetëm kleri, i cili, tanimë, i kishte bërë hapat drejt transformimit të *Lidhjes së Vjetër* (the old league) nga e ashtuquajtura *organizatë nacionale* në një *organizatë thjeshtë fetare*, dhe mendonte t'i kundërshtojë të krishterët, si në vend ashtu edhe jasht tij.

Shef Mustafa ende pretendon të ketë marrëdhënie sekrete me titullarët e lartë të Pallatit të Sulltanit, e shenjëzat tregojnë se Qeveria pasi që e zbuloi se preteksti i aspiratave nacionale e përqëndroi vemendjen e shqiptarëve në mënyrë të rrezikshme në punët e brendshme të vendit të tyre, e preferon kthesën fetare tani të adaptuar, pasi që ajo është njëra e cila do të mund të ushtronte ndikim në provinca të okupuara të Bosnjës dhe të Hercegovinës, dhe mund të ofronte rezistencë më efikase kundër depërtimit austriak në Sanxhakun e Jeni Pazarit, pa e kompromituar haptazi vetë Qeverinë Turke.

Besoje se në qoftë se nuk merren disa masa vendimtare nga Porta për të ndaluar shpërdorimin pa leje të emrit të saj nga sheh Mustafa dhe të tjetër, çdo formë e mundshme dhe e trilluar do t'i jepte kinse popullaritet në Shqipëri, dhe se, pa tjetër, çdo ndryshim do ta afronte më afër motivit të rrezikshëm.

Lehtësia me të cilën Qeveria Turke që e zonja për ta përmbysur brenda tri javëve të fundit opozitën e organizuar gjashtë mujore kundër dorëzimit të territorit shqiptar e çfajson atë prej çdo akuze të pazotëtisë që të veprojnë energjikisht dhe ajo duhet të nxitet që të mposhtë menjëherë makinerinë e cila nuk mund t'i shërbente më gjatë.

Kam nderin, etj.

(Nënshkrimi) W. Kirby Green.

(Public Record Office, London, *F. O. 424/80*, pp. 333).

#### 9. *Mr. St. Johni kontit Granville*

Im Lord,

Stamboll 29 dhjetor 1880.

Thashethemet për një kryengritje të përgjithshme në Shqipëri kundër pushtetit osman u përhapën në të katër anët, e në Stamboll janë aq bindëse sa që u detyrova të mbledh ca shënime për t'u vërtetuar se a kanë

ato farë baze. M'është thënë tani se deputacioni nga Bidou (ndoshta: Bitoli-Manastiri — S.R.) i cili arrijti këtu qysh prej kohës që t'i bëjë lutje Sulltanit kundër dorëzimit të Ulqinit, kurrë nuk u pranua nga lartmadhëria e Tij, por se, Abdyl beu, udhëheqësi i shquar i Shqipërisë Veriore (Jugore — S.R.), pat sukses të pranohet. Megjithëqë pranimi i tij, marrë në përgjithësi, ishte i përzemërt, kur e paraqiti dëshirën e shqiptarëve që të shohin vendin e vet të bashkuar nën qeverisjen e një valiu, në vend të katër sish, sa ishin tani, ai (Abdyl Frashëri — S.R.) e lëshoi praninë e Lartmadhërisë i bindur se kërkesa kurrë nuk do të aprovohet. Abdyl beu banonte në Stamboll deri para disa ditësh, kur, zbuloi se përcillej nga agjentët e Pallatit. Prandaj iku papandehur. Tani është në rrugën e vet për në Shqipëri, ku do t'i thërret bashkatdhetarët e vet për t'u ngritur në kryengritje të armatosur.

Thuhet se Qeveria është duke dërguar me shpejtësi sasi të mëdha të municionit për në Selanik, për t'u mbartur me tren ç'prej aty për në Shkup. E Lidhja, nga ana tjetër, është duke marrë masa, për të minuar binarët, për të hedhur trenin në ajër gjatë kalimit.

M'është thënë se nga Shqipëria Veriore, dy emisarë të Ali pashë Gucisë, u dërguan te Princi i Malit të Zi, me lajmin se, Ulqini i takon shqiptarëve e jo Sulltanit. Prandaj Princi duhet t'ia dorëzojë atë krahinë pronarëve legjitim, përkundrazi do të përgatitet një sulm kundër Principatës së tij.

Disa prej tyre të cilët e përbënin delegacionin shqiptar të sipërpërmendur, nuk dijnë për çfarë motivi, shfaqën dëshirën e tyre që të bisedojnë me mua, të cilët, në këto rrethana, vendosa t'i refuzojë.

Kam nderin, etj.  
(Nënshkrimi) F.R.St. John.

(Public Record Office, London, *F. O. 424/110*, pp. 9.)

1. *Acting Consul Summa to the Marquis of Salisbury*

(Telegraphic.)

Scutari, June 14, 1878.

THE Montenegrin Voivoda, Verlitz, who returned on the 11th to Cettigné, declared to Vali that the question regarding the evacuation of position occupied by the Montenegrin troops after the armistice could only be decided by the Congress. On the 10th a protest was sent to the Grand Vizier, signed by the inhabitants of Podgoritza, Scutari, all the mountaineers, and also by the Mirdites. The signers declared that they will resist with arms any cession of land, and they have demanded by telegraph the inhabitants of all the Albanian districts to join the league. In case of a

cession of territory being granted to the Montenegrins beyond the positions they now occupy, precautions must be taken, and strict orders sent to the Governor of Scutari to Prevent an effusion of blood.

(Sent to the British Ambassador).

(Public Record Office, London, *F. O. 424/71*, pp. 174.)

### 2. *Acting Consul Summa to the Marquis of Salisbury*

(Telegraphic.)

Scutari, July 9, 1878.

